



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9243 prot.

Himarë, më 30.12 . 2025

VENDIM

Nr. 62 , Datë 22/12 /2025

**“PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË
BASHKISË HIMARË PËR VITIN 2026”**

Në bazë të pikës 2, të nenit 8, pikës dh, të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, (i përditësuar), ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i përditësuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i përditësuar, si dhe në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Informacionit dhe Shërbimeve Digjitale dhe Drejtoria Juridike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë: Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 22.12.2025, pasi shqyrtoi materialin e sjellë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Informacionit dhe Shërbimeve Digjitale dhe Drejtoria Juridike e miratoi me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, 8 (tetë) kundër, 0 (zero) abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI:

1. Miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2026, i cili do të jetë 333 punonjës.
2. Numri i administratës të Bashkisë Himarë do të jetë 227 dhe numri i punonjësve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë do të jetë 106.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë për vitin 2026.
4. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet *Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Informacionit dhe Shërbimeve Digjitale dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.*

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i përditësuar.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

